URDHËR
Nr. 218/1, datë 22.9.2017

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, zëvendësministrit të Brendshëm, znj. Rovena Voda, për këto çështje:

a) trajtimin dhe ndjekjen e procedurave për fitimin, rifitimin ose humbjen e shtetësisë shqiptare;

b) nënshkrimin dhe paraqitjen e kërkesës, së bashku me dokumentacionin shoqërues, për fitimin, rifitimin ose humbjen e shtetësisë shqiptare, pranë Presidentit të Republikës;

c) trajtimin dhe nënshkrimin e kërkesave për informacion, nga persona fizikë dhe juridikë, shtetas shqiptarë dhe/ose të huaj, që kanë të bëjnë me shtetësinë shqiptare.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Brendshme, për çështjet e përcaktuara në germat "a", "b" dhe "c", të pikës 1, të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data 22.9.2017 deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Brendshëm, znj. Rovena Voda.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Fatmir Xhafaj